

Botushë, 6.8.2013

Me insistimin e kryesisë së Shoqates Humanitare „Jerina“ dhe me perkrahjen e bashkëvendasëve nga Fshati, u mbajt mledhje informative në Oborrin e Xhamisë së Fshatit.

Mbledhja kishte vetem një rend dite dhe kishte të bënte rreth njoftimit për ngritjen e një Objektivit ndihmes në kuader të fshatit për raste emergjente. Një objektë të tillë kishte kërkuar z. Dervish Avdiu i cili ishte musafir në Zvicër dhe kishte marr pjesë në mledhjen e fundit të Shoqates Humanitare „Jerina“. Objekti që kërkon Fshati është: Një sallë e madhësisë së mesme, me Objektet percjellse, për nevoja të përbashkëta të Fshatit në raste të ndonji të Pamje apo Pritje, pse jo edhe për ndonji qëllim tjerër si gazmend, tubim etj.

Tubimi filloi në frymën vllazrore dhe kishte një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve. Pas diskutimeve të shumta u arrit pajtueshmëri që objekti në fjalë mundet të ndërtohet vetem në Sadra sepse vend të mjaftueshëm për objekt dhe objektet percjellse në fshat nuk ka. Vendi afër Xhamisë është shumë i vogël dhe se do të ket probleme me Parkimin.

Në fund u mor vendim që edhe njëher të shqyrtohet kërkesa në detale, të zgjidhet Plani dhe vendi, dhe të njoftohen të gjith bashkëvendasit kudo që janë.

Tubimi përfundoi në frymën vëllazërore dhe me qmallje të bashkëvendasëve ndërmjet veti.

©www.botusha.li

Disa Foto nga Tubimi në Botushë me 6.8.2013





